



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Kamëz, më ____/____2023

NJOFTIM!

Referuar ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 22/2018, datë 03.05.2018 "Për strehimin social" i ndryshuar; VKM-në nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; VKM nr.459, datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin".

Njoftohen të gjithë familjet e pastreha të Bashkisë Kamëz, që janë shpallur fitues në fazën e parë dhe duan të aplikojnë për fazën e dytë të programit Subvencionimit të qirasë për familjet në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2024, të paraqiten pranë institucionit të Bashkisë Kamëz në sportelin One Stop Shop për dorëzimin e dokumentacionit sipas listës së dokumentave të kërkuar nga sektori Strehimit në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit për programin e Subvencionimit të Qirasë do të jetë nga data 06.12.2023 deri më 05.01.2024 në sportelin One Stop Shop.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTOR

Teuta CAMI